



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice**  
*Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija Ljudkih Resursa / Human Resources Division*

DBNJ -Nr. 23 /2022

Datë: 13.10.2022

Duke u bazuar në nën -paragrafin 3.1 të paragrafit 3 dhe 4 të nenit 68 të Ligjit Nr. 06/L -114 për Zyrtarët Publik (Gazeta Zyrtare Nr. 8 / 11 mars 2019), Ligjin Nr. 03/L 212 të Punës dhe nën -paragrafin 5.1 të paragrafit 5 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik si dhe nënin 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëheqësja e Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, nxjerr:

**VENDIM**

**mbi anulimin e Konkursit të jashtëm në IML për këto Pozita:**

1. Anulohen procedurat e rekrutimit sipas Konkursit të jashtëm në Institutin e Mjekësisë Ligjore të publikuara me datën e njoftimit 11.08.2022, në afatin për aplikim nga data 10.09.2022 deri 24.09.2022 për këto Pozita:
  - 1.1 Drejtor i Departamentit për Mbështetje Mjeko -Ligjore - 1 (një) vend pune
  - 1.2 Drejtor i Departamentit për Mjekësi Ligjore - 1 (një) vend pune;
  - 1.3 Udhëheqës i Divizionit për Cilësi - 1 (një) vend pune;
2. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

**ARSYETIM**

Divizioni për Burime Njerëzore gjate fazës së verifikimit paraprak ka konstatuar se Konkursi i jashtëm i publikuar për aplikim me datën 10.09.2022 për Pozitat: Drejtor i Departamentit për Mbështetje Mjeko -Ligjore -1 (një) vend pune, Drejtor i Departamentit për Mjekësi Ligjore - 1 (një) vend pune dhe Udhëheqës i Divizionit për Cilësi -1 (një) vend pune, duhet të përsëriten sepse se paku tre (3) kandidatë nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara për këto Pozita të shpallura me konkurs, e i cili duhet të përsëritet brenda afatit ligjor të paraparë me Ligj.

Andaj, bazuar në nën -paragrafin 3.1 të paragrafit 3 dhe 4 të nenit 68 të Ligjit Nr. 06/L -114 për Zyrtarët Publik (Gazeta Zyrtare Nr. 8 / 11 mars 2019), Ligjin Nr. 03/L 212 të Punës dhe nën -paragrafin 5.1 të paragrafit 5 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në

Sektorin Publik si dhe nenin 44 te Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Arta Nuredini -Durmishi

*Arta Nuredini*

Udhëheqëse e Divizionit të Burimeve Njerezore